

E botuar ne shtyp dt 11.08.2012

ME STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE DHE REFORMËN E QEVERISË NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË 2012 - 2020 NUK MUND TË FUNKSIONOJNË TË DREJTAT E NJERIUT, SISTEMI DEMOKRATIK DHE SHTETI LIGJOR.
Nga kryesia e Shoqatës "Bregdeti"

Asnjëherë gjatë këtyre 10 vjetëve nuk është diskutuar dhe nuk kanë dalë përgjegjësitë lidhur me faktin se pas vitit 2001 vazhdon të shkelet detyrimi i përcaktuar në nenin 181 të Kushtetutës për zgjidhjen ligjore, brenda 3 vitesh, të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41 që garantojnë të drejtën e pronës.

Kthimi fizik i pronës tek i zoti, që duhej të ishte veprimi i parë i qeverisë demokratike në 1991-92, akoma nuk ka përfunduar. Dokumenti prej 50 faqesh i Strategjisë së Qeverisë 2012-2020 për respektimin e të drejtës së pronësisë, me të cilin Qeveria pretendon se ka hartuar një mekanizëm realist për t'u zbatuar në praktikë, është i gabuar. KJO ËSHTË STRATEGJIA E SHKELJES SË TË DREJTËS SË PRONËSISË DHE MBROJTJE E KORRUPSIONIT PUSHTETAR. Strategjia e Qeverisë 2012-2020 mohon të drejtën e pronës pronarëve autoktonë, dhe legjitimon transferimin e pronës tek politikanët. Si e tillë ajo i shërben pseudo demokracisë dhe vrasjes së ngadalshme të popullit shqiptar.

Strategjia konstaton anarkinë e pronës, maskon një pjesë të shkaqeve që kanë çuar në këtë anarki, ka si bosht rrugën e gabuar të Ramiz Alisë dhe të Katovicës, nenin 8 të ligjit 7501 dhe qëndrimin antipronar dhe mos kthimin fizik të pronës tek subjekti i shpronësuar. Kjo strategji shkel Kushtetutën, justifikon vjedhjen e pronave dhe neglizhon faktin se çdo pronë që nuk kthehet fizikisht transformohet në faturë financiare (rastet kur është pronë e pa ndryshuar dhe mund të kthehet siç janë trojet turistike, tokat bujqësore etj). Duke pretenduar kompensim në vend të kthimit fizik, "strategjia e re" shton pengesat të tjera burokratike për pronarët dhe e zvarrit zgjidhjen deri në vitin 2020.

Në vitet 1991-92 pas përmbysjes së komunizmit u eksperimentua fryma e shkatërrimit dhe rezultatet dihen (Në zonën Vlorë Sarandë u prenë me sopatë mijëra agrume dhe ullinj dhe qindra hektarë tokë degraduan pasi u lanë pa punuar). Strategjia 2012-2020, që pretendon të rregullojë të drejtat e pronësisë, po eksperimenton se çfarë do të rezultojë në një vend me administratë dhe gjykata të korruptuara, kur kthimi fizik i pronave që duhet të ishte bërë që në vitet 1991-92 shtyhet deri në vitin 2020, në kushtet kur qytetarëve u kërkohet të paraqiten në 8 institucione që nuk pyesin për njëri tjetrin, kur kthimi i pronës rregullohet me një mori ligjesh që kundërshtojnë njëri tjetrin dhe bien ndesh me Kushtetutën. Është e tepërt të shtojmë se nuk ka asnjë garanci se Qeveria që do jetë në 2020 nuk do ta shtyjë këtë përdjudhë si një proces tranzicioni që nuk mbaron. Hartuesit e këtij dokumenti ashtu si dhe ata që hartuan ligjin 7501 praktikisht synojnë të justifikojnë zyrtarizimin e grabitjes postkomuniste të pronës, që duhet ti kthehet pronarëve të ligjshëm.

Në hyrje të këtij dokumenti (pragrafi 4 në faqen 4) thuhet se "Parimet që udhëheqin strategjinë janë të dimensionit kushtetues". Kjo bie ndesh me zhvillimet faktike në zonën turistike ku kjo strategji synon të justifikojë vjedhjet në emër të ligjit në vitet 1991-2012 të pronës private. Me këtë strategji nuk mund të funksionojë shteti ligjor

sepse mohohen të drejtat e njeriut dhe parimi themelor i sistemit demokratik.

Të bën përshtypje fakti se kjo Strategji e Qeverisë, ngjan si dy pika uji me qëndrimin e Bankës Botërore. Raporti i Bankës Botërore, vazhdon të përdorë termin "ish-pronarët" për të treguar pronarët dhe pohon se zgjidhja e pronave mbetet një sfidë e qeverisë! Banka Botërore konstaton shkeljet e ligjeve, por nuk analizon detyrimet kushtetuese dhe shkeljen e të drejtës së pronësisë nga ligjet në fuqi. "Specialistët" e këtij institucioni prestigjioz, që na i prezantuan si specialistë të ardhur nga SHBA, nuk i morrën në konsideratë argumentat dhe ankesat e përseritura të Shoqatës Bregdeti. Këta specialistë të çuditshëm lanë në heshtje zgjidhjen që i ka ofruar shoqata, dhe rekomanduan shkeljen e ligjit për legalizimin e ndërimeve pa leje, pa marrë në konsideratë se ato ndërtime pa leje janë bërë mbi tokën e shtetit apo mbi tokën e pronarëve. Këta pseudospecialistë ngatërrojnë konceptet që të justifikoj rrugën antipronare të Strategjisë së Qeverisë. Ata sjellin shembullin e Maqedonisë, por ky shtet nuk ka kompensuar 100 përqind pronat e dëmtuara pas tërmetit të 1963, por ka kthyer 100% tek pronarët pasuritë e shtetëzuara nga komunizmi. Këtë ligj Parlamenti i Maqedonisë e ka miratuar me urgjencë dhe me procedurë të shpejtuar në prill 1998, nën presionin e FMN dhe të Bankës Botërore.

Specialistët e Bankës Botërore nuk mund të shërbejnë për të mbrojtur strategjinë e Ramiz Alisë dhe të Katovicës, që pronari autokton të zhvishet nga prona e trashëguar dhe të humbasë identitetin, historinë tonë shekullore të pronësisë, ndërsa politikanët të bëhen pronarë të bregdetit, të tokës dhe detit. Banka Botërore dhe Strategjia e Qeverisë Demokratike nuk kanë asnjë të drejtë të disponojnë pronat që ka grabitur monizmi, ata nuk kanë asnjë të drejtë të caktojnë çmimin për shpërblimin e pronës. Ato kanë të drejtë ta bëjnë këtë vetëm kur prona është tjetërsuar për nevoja publike ose do të shfrytëzohet për nevoja publike.

Këtë e evidentoi vendimi pilot i datës 31.07.2012 i Gjykatës së Strasburgut. Ky Vendim ndaloi uljen e çmimit sipas dëshirës së Qeverisë, çka imponon korigjimin e akteve të gabuara, respektimin e të drejtës së pronësisë dhe kthimin fizik të pronës edhe në zonat turistike. Zgjidhja është e thjeshtë dhe ne e kemi përgatitur draftin për pronat. Zgjidhja duhet të fillojë me regjistrat e shpronësimeve komuniste të cilat shteti i disponon. Paguesa me 3 milion Euro për të katër rastet mbi të cilat shprehet vendimi pilot i 31.07.2012 do të ekzekutohet nga Qeveria pa një e pa dy. Alternativa e vetme e Shtetit është që tu kthejë fizikisht pronën pronarëve (tokë bujqësore troje etj pavarësisht nga zëri kadastral) dhe të mos e zëvendësojë kthimin fizik me kompensim. Specialistët e Strategjisë dhe të Bankës Botërore duhet të kuptojnë rrugën e gabuar. Që qeveria të detyrohet ta bëjë këtë veprim sa më parë duhet që të gjithë pronarët që kanë vendime gjykatash të çdo shkalle që kanë marrë formë të prerë dhe nuk janë ekzekutuar apo ata që kanë vendime nga Komisionet e pronave për kompensim ose për kthim fizik që nuk janë ekzekutuar, t'i drejtohen individualisht me ankesa me postë Gjykatës së Strasburgut. Edhe sikur politika shqiptare të vazhdojë të insistojë në papërgjegjshmërinë 20 vjeçare të derisotme, ankesat për pronat do zgjidhen në Strasburg, në mënyrë të ngjashme me vendimin pilot të datës 31.07.2012 maksimumi pas 18 muajsh. Dihet se shpenzimet për ta dërguar ankesën me postë në Strasburg praktikisht janë minimale dhe për subjektet me të ardhura të pakta Strasburgu vendos dhe paguan shpenzimet e avokatit dhe shpenzimet e tjera.